



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO

Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Data	18.11.2024	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	09-104/k2-29277/24		

Kaçanik, 18. 11. 2024

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjës financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve - klubeve dhe shoqatave sportive lidhur me realizimin e aktiviteteve të rregullta kulturo-sportive, mbështetur në Planin e punes së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2024-Manifestimi Kulturo-sportiv "Laureatët e Vitit 2024"

- 1. Komuna e Kaçanikut- Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport duke u bazuar në Rregulloren MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare/klubeve dhe shoqatave kulturoo-sportive/ të Regjistruara ne Republikën e Kosoves, të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut, programi i punes i të cilave është i fokusuar në realizimin e aktiviteteve kulturo, rinore e sportive.**
- 2.OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objektiv zbatimin e aktivitetit kulturo-sportiv: "Laureatët e vitit 2024 "**
- 3.Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 1000 euro (Euro).**

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune duke filluar nga data 19.11.2024 dhe përfundon me datën 09.12.2024, ndërsa periudha e zbatimit të projektit është në muajin dhjetor 2024.
5. Te drejte aplikimi me projektet e tyre kane OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës e te cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut, së paku nje vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të keë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ- të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
6. Para nënshkrimit të kontrates, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale,.
7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, te cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare : *Komuna e Kaçanikut /Shpalljet*
8. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në sportelin e zyrës së pritjes të objektit të komunës së Kaçanikut.
9. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
10. Të gjitha qështjet që lidhen me thirjen publike mund te sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar në e-mail në adresën: hafize.sallahi@rks-gov.net

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Hafize Sallahi-Drejtoreshë

